

ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË FERIZAJIT 2012

VOTIMI PËRMES POSTËS

1. Aplikoni për regjistrim
2. Merrni fletëvotimin (Shkarkoe nga webfaqja: www.kqz-ks.org)
3. Dërgojeni me postë fletëvotimet e shënuara

Nëse jeni nga Kosova, respektivisht nga Komuna e Ferizajit dhe jetoni jashtë Kosovës, ju mund të aplikoni për të votuar përmes postës për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajit që do të mbahen më 29 Prill 2012.

Aplikacionin për Votim Përmes Postës mund ta merrni nga burimet vijuese:

- www.kqz-ks.org
- Linja ndihmëse e Programit për të Votuar nga jashtë Kosovës:

Tel: +381 (0) 38 211 152 ose

Fax: +381 (0) 38 211 008

- Ambasadat e Republikës së Kosovës
- Organizatat Lokale të Diasporës

Për të pasur të drejtë që të votoni nga jashtë Kosovës ju duhet që:

- Të keni moshën 18 vjeçare në ditën e votimit më 29 Prill 2012
- Të jeni të regjistruar në Regjistrin Civil të Kosovës dhe të posedoni dokumentin e vlefshëm të Identifikimit të Kosovës

apo

vërtetimin që vërteton se jeni person legjitim për t'u regjistruar në Regjistrin Civil të Kosovës.

KUJDES

Nëse ju posedoni dokument të identifikimit të Kosovës ose të UNMIK-ut me afat të skaduar, ju lutemi që së bashku me kopjen e këtij dokumenti, dërgojeni edhe një kopje të një dokumenti valid të identifikimit të shtetit ku jetoni.

Aplikacionet për Votim Përmes Postës duhet të pranohen apo arrijnë para 09 Prillit 2012. Prandaj ju lutemi që të filloni menjëherë.

SI TË MERRNI PJESË

1. Dërgojeni një formularë regjistrimi së bashku me kopjet e dokumenteve identifikues para 9 Prillit 2012.

2. Fletëvotimet do të ju dërgohen në adresën tuaj, ose do të ju ofrojmë t'i shkarkoni nga webfaqja e KQZ-s: www.kqz-ks.org. Ju mund t'i fotokopjoni fletëvotimet apo edhe t'i merrni nga pikat e shpërndarjes.

3. Shënjoje (plotësoe) fletëvotimin dhe dërgoje në:

SEKRETARIATI I KQZ-SË NË KOSOVË VOTIMI PËRMES
POSTËS K.P. 6. KUTIA 351 10000 PRISHTINË, KOSOVË

TË GJITHA FLETËVOTIMET E ARRITURA PAS 29 PRILLIT 2012 NUK DO TË NUMËROHEN.

KUSH MUND TË MARRË PJESË ?

Për të plotësuar kushtin që të votoni nga jashtë Kosovës ju duhet që:

- Të keni moshën 18 vjeçare në ditën e votimit më 29 PRILL 2012.
- Të jeni të Regjistruar në Regjistrin Civil të Kosovës dhe të posedoni dokumentin e Identifikimit (DI) të lëshuar nga Kosova

Apo

- Vërtetimin që vërteton se jeni person legjitim për t'u regjistruar në Regjistrin Civil të Kosovës.

Për votuesit që kanë votuar me postë në zgjedhjet e kaluara është më lehtë të marrin pjesë.

Vetëm dërgojeni formularin tuaj duke konfirmuar identitetin tuaj, adresën tuaj së bashku me dokumentet e kopjuara mbështetëse.

Aplikuesit e rinj duhet të plotësojnë tërë formularin dhe të dërgojnë së bashku me dokumentet mbështetëse të cilat dëshmojnë legjitimitetin e tij për të votuar.

Që të keni zotësi juridike për t'u regjistruar në Regjistër Civil të Kosovës duhet të përmbushni njërin nga:

- Dëshmojë vendbanimin e tij në Kosovë në datën 01/01/1998
- Të plotësoj njërin nga kriteret e poshtëshënuara:
 - I lindur në Kosovë
 - Së paku njëri nga prindërit tuaj ka lindur në Kosovë
 - Keni jetuar në Kosovë për pesë vjet me radhë
 - Keni qenë të dëbuar nga Kosova dhe nuk keni mundur të jetoni në Kosovë për pesë vjetët e fundit.
- Jeni fëmijë i varur nën 18 vjeç, i një personi të regjistruar civil në regjistrin civil të Kosovës
- Jeni fëmijë i varur i moshës nën 23 vjeçare, i një personi të regjistruar në regjistrin civil të Kosovës dhe jeni student i një institucioni të njohur në aspektin ligjor.

Për informacione të më tutjeshme lidhur me Operacionin e Votimit Përmes Postës, ju lutemi që të vizitoni faqen tonë të internetit: www.kqz-ks.org, apo të thirrni linjën tonë ndihmëse:

Tel: +381 (0) 38 211 152 ose

Fax: +381 (0) 38 211 008